REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar-Pranjeno Me Dana 18-09-2026

Nr. I organit Org. Broj	Numri Broj	Shtojca Prilog	Viera Vrednost
01-	110/05-	1027	

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, neni 17, neni 40, paragrafi 40.2, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008), dispozitave të Ligji Nr.03/L-049, për Financa e Pushtetit Lokal të datës 13.03.2008, Qarkoren Buxhetore 2027/02, të datës 14.08.2026, të lëshuar nga MFPT-ja me Nr.987-2/2026, ku paraqet bazë për hartimin e buxhetit për vitin 2027-2029, nenit 35, paragrafi 35.2, pika b, nenit 36 shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 25.09.2026 miraton këtë:

V E N D I M
për aprovimin e Buxhetit të Komunës së Vitisë për vitin 2027-2029

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton Buxhetin e Komunës së Vitisë për vitin 2027 - 2029, duke u bazuar në Qarkoren Buxhetore 2027/02, të datës 14.08.2026, të lëshuar nga MFPT-ja me Nr.987-2/2026, ku paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2027-2029.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është PROJEKT BUXHETI I KOMUNËS SË VITISË 2027-2029, i hartuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim. Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2027 është në shumë prej 18,388,643 €, buxheti për vitin 2028 është në shume prej 18,319,667 €, buxheti për vitin 2029 është në shumë prej 19,292,038 €.

Neni 3

Burimet e buxhetit janë: të hyrat nga grandi qeveritar dhe nga të hyrat vetanake komunale.

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e Komunës së Vitisë për vitin 2027 janë: 18,388,643 €

a) Të hyrat nga Grandi Qeveritar ..... 17,054,305 €
b) Të hyrat vetanake komunale ..... 1,334,338 €

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e Komunës së Vitisë për vitin 2028 janë: 18,319,667 €

c) Të hyrat nga Grandi Qeveritar ..... 16,947,181 €
d) Të hyrat vetanake komunale ..... 1,372,486 €

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e Komunës së Vitisë për vitin 2029 janë: 19,292,038 €

e) Të hyrat nga Grandi Qeveritar ..... 17,899,891 €
f) Të hyrat vetanake komunale ..... 1,432,146 €

Buxheti për vitin 2027 shpërndahet në këto kategori ekonomike :

Paga e mëditje	11,480,849. €
Mallra e shërbime	3,013,919. €
Shpenzime komunale	290,000. €
Subvencione dhe transfere	720,000 €

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr.08/L284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr.08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27, dhjetor 2024), nenin 5, paragrafi 1, si dhe nenin 8, lidhur me nenin 9, paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare, në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:
1. Zyra së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Financa;
3. Shërbimit të Kuvendit;
4. MAPL-së; dhe
5. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi